



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente

Datë: 30.03.2023

08 Nr. 052-11286/23

**Raporti nga Dëgjimi Publik për Draft - Rregulloren për Menaxhimin e
Mbeturinave në Komunën e Klinës si dhe Planin Komunal për Menaxhimin e
Mbeturinave 2023-2027.**

Mars, 2022

Hyrje

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Klinës, në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023 – 2027, paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. PKMM ofron kornizën konceptuale për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeçare për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike.

Objekti i PKMM është që të analizojë situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), të identifikojë çështjet dhe mangësitë, të vlerësojë pikat e forta dhe të dobëta.

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023 – 2027, do të shërbejë si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

Hartimi i planit lokal për menaxhim të integruar të mbeturinave është mbështetur në pjesëmarrjen aktive të institucioneve përkatëse lokale dhe atyre qendrore, të komunitetit dhe organizatave joqeveritare. Realizimi i programeve dhe aktiviteteve të propozuara në plan do t'i referohet mundësive për zhvillim ekologjik të komunës së Klinës dhe qasjes sistematike dhe gjithëpërfshirëse me implikime afatgjata për jetën e qytetarëve të komunës sonë.

Ecuria e procesit të dëgjimeve publike

Kryetari i Komunës së Klinës, në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimeve Publike, duke respektuar Udhëzimin Administrativ NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka filluar procedurën për themelimin e Grupit Punues me gjithsej pesë anëtarë si dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për Koordinimin e Konsultimeve Publike.

Grupi punues ka hartuar planin e brendshëm të organizimit të dëgjimeve publike, ku është specifikuar të mbahet 1(një) dëgjim publik në sallën e Kuvendit Komunal Klinë.

Gjithashtu, këto dy dokumente kanë qenë në konsultim për publikun edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe në Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike.

Grupi punues në njoftimet për organizimin e dëgjimeve, ju ka mundësuar qytetarëve të kenë mundësi të dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre për Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës si dhe Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, në dy emaillet zyrtare:

1. ahmet.berisha@rks-gov.net,
2. vlora.tafili@rks-gov.net.

Gjithashtu edhe dërgimin e komenteve në kopje fizike me shkrim, në **shërbimin për punë të Kuvendit, kati I, zyra e dytë**.

Pajisja me materialet e nevojshme i është dhënë mundësia të gjithë qytetarëve të merret në formë fizike në Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit, po ashtu ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe në Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike.

Ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>

Platforma e Qeverisë:

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41790&Language=al&fbclid=IwAR3gMKBW8A3QFV3enf4aZTuWVS_njhUtA4C8-ZChzRmatGJzYvSF5QasNXc

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime.
1. Takimi i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë	28.03.2023, 2 orë.	26 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa.
2. Publikimi në ueb-faqe / platforma elektronike	11 ditë	0 pjesëmarrës	0 kërkesa të parashtruara.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft - Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës si dhe Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve publike, do të finalizohet dhe të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Klinës si dhe do të publikohet në ueb -faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerime për projekt-buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës.	Kërkesë për vendosjen e një kontejneri 1.1 në fshatra.	Qytetari Drilon Morina.	Refuzohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese, vendosi që kjo kërkesë të refuzohet me arsyeshmërinë se afër kontejnerëve mund të krijohen deponi të vogla ilegale.
Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës.	Kërkesë për organizimin dhe promovimin e fushatave vetëdijesuese për sensibilizimin e qytetarëve për kujdes të shtuar ndaj ambientit.	Qytetarja, Vlora Tafili	Pranohet.	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, pranoi këtë propozim pasi që e përfshinë Neni 27, për Informim dhe promovim.

Në lidhje me Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës si dhe Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 u diskutua dhe kishte komente pozitive nga të pranishmit lidhur me menaxhimin e mbeturinave nga qytetarët, Ragip Kryeziu, Idriz Beqiri, Nysret Berisha.

Klinë, 30.03.2023

Kryesuesi i Grupit Punues

